

GRANTE TË BASHKËFINANCUARA PËR
SHOQËRITË TREGTARE TË
SAPOTHEMELUARA START-UP DHE SPIN-OFF

START-UP



Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

FIZHT
FONDI I
INOVACIONEVE
DHE I ZHVILLIMIT
TEKNOLOGJIK

Qëllimi i thirrjes publike është të inkurajohet zhvillimi i inovacionit tek ndërmarrjet e sapothemeluara përmes sigurimit të mbështetjes së nevojshme financiare për aktivitetet në lidhje me hulumtim dhe zhvillim. Gjithashtu, pritet të inkurajojë zhvillim të kulturës së marrjes së rrezikut dhe inovacionit, të sigurohet mbështetje për personat juridikë që dëshirojnë të zhvillojnë produkt, proces dhe/ose shërbim të ri apo të përmirësuar, si dhe të inkurajohet komercializimi i rezultateve nga hulumtimet e kryera në kuadër të institucioneve të arsimit të lartë respektivisht të institucioneve hulumtuese-shkencore.



Çfarë projekte mbështesim?

- **Mbështetja përmes këtij instrumenti do t'u ndahet projekteve që kanë të paktën "dëshmi të konceptit" (proof of concept) dhe ambicie të qartë për komercializim.**
- **Instrumenti mbështet projektet të cilët janë në fazën e dëshmis së konceptit deri në fazën e parakomercializimit (paratregut).**

Kush mund të aplikojë?

Shoqëria tregtare e themeluar në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Nga momenti i regjistrimit të shoqëris tregtare deri në momentin e paraqitjes së një propozim-projekti në Fond të mos kenë kaluar më shumë se 6 (gjashtë) vite dhe numri mesatar i të punësuarve nuk duhet të kalojë 250 të punësuar.

Ekip projekti prej më së shumti 5 anëtarë. Aplikuesi është i detyruar që brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së Njoftimit për përzgjedhjen e propozim-projektit, të themelojë shoqëri tregtare.

Të ardhurat vjetore të aplikuesit nuk duhet të kalojnë 1,000,000 (një milion) euro në kundërvlerë të denarit, sipas raporteve financiare për dy vitet e mëparshme fiskale.

Cilat aktivitete i mbështesim?




AKTIVITETE PËR HULUMTIM DHE ZHVILLIM



ZHVILLIM TË LINJAVE PILOT/PRODHIM/E DHE/OSE SHËRBIM/E



AKTIVITETE PËR TESTIMIN DHE VALIDIMIN E PRODUKTEVE/SHËRBIMEVE/PROCESEVE TË REJA DHE/OSE PËRPARUESE



AKTIVITETE PËR TESTIMIN E TREGUT DHE VALIDIMIN E SHFRYTËZUESVE POTENCIALË



AKTIVITETE TË LIDHURA ME MBROJTJEN E PRONËSISË INTELEKTUALE DHE DIZAJNIT

Shpenzime të përshtatshme për financim

- PAGAT BRUTO PËR PERSONAT QË JANË OSE DO TË PUNËSOHEN NGA SHFRYTËZUESI DHE MARRIN PJESË DREJTPËRDREJT NË ZBATIMIN E PROJEKTIT
- FURNIZIMI DHE/OSE HUAZIMI I PAJISJES DHE MATERIALE HARXHUESE PËR HULUMTIM DHE ZHVILLIM
- SHËRBIMET E NËNKONTRAKTUARA PËR HULUMTIM DHE ZHVILLIM (P.SH. TESTIMI, SHËRBIMET LABORATORIKE, ETJ.)
- ANGAZHIMI I EKSPERTËVE/KËSHILLTARËVE PËR HULUMTIM DHE ZHVILLIM
- ANGAZHIMI I KONSULENTËVE PËR NEVOJA TË LIDHURA DREJTPËRDREJT ME REZULTATET E PROJEKTIT
- PËRGATITJA DHE PARASHTRIMI I KËRKESËS PËR PATENT, MBROJTJE TË MARKËS TREGTARE DHE/OSE DIZAJNIT INDUSTRIAL
- MBËSHTETJE PËR ZYRËN DHE BIZNESIN (NË NJË SHUMË MAKSIMALE DERI NË 15% TË BUXHETIT TOTAL TË PROJEKTIT)

€2,000,000

MBËSHTETJE PËR EKOSISTEMIN STARTUP TË MAQEDONISË



Shuma e mbështetjes

€40,000

DERI NË 90% TË BUXHETIT TË PËRGJITHSHËM TË PROJEKTIT, PËR SHOQËRITË TREGTARE DERI NË 3 VITE EKZISTENCË DERI NË MOMENTIN E APLIKIMIT OSE PËR PROJEKTET E DORËZUARA NGA EKIPI I PROJEKTIT

€60,000

DERI NË 85% TË BUXHETIT TË PËRGJITHSHËM TË PROJEKTIT, PËR SHOQËRITË TREGTARE ME MË SHUMË SE 3 DHE MË PAK SE 6 VITE EKZISTENCË DERI NË MOMENTIN E APLIKIMIT

**MJETET E MARRA JANË PA KTHIM!*

Evalrimi i projekteve

- Faza e para-përzgjedhjes zbatohet nga tre ekspertë vendas. Dy ekspertë nga fushat që korrespondojnë me kriteret e evaluimit dhe një person nga fusha që korrespondon me propozim projektin.
- Faza e përzgjedhjes zbatohet nga Komisioni i Miratimit të Investimeve i cili merr vendimin përfundimtar për financimin nëpërmjet këtij Instrumenti.



**Kohëzgjatja e projektit për të cilin janë
ndarë mjetet përmes këtij instrumenti mund
të jetë deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj.**



SI I VLERËSOJMË PROJEKTET

SHKALLA E INOVACIONIT;

CILËSIA E PROJEKTIT

KAPACITETI I EKITIT TË PROJEKTIT

POTENCIALI I TREGUT

NDIKIMI

Dokumentacioni i projektit

- Formular i plotësuar qartë për aplikimin e projektit
- Formular i plotësuar qartë për buxhetin e projektit
- Deklaratën e aplikantit për pranimin e kushteve të Fondit
- Pyetësor i plotësuar qartë për mjedisin jetësorë dhe
- Deklaratë e noterizuar për pronësinë - struktura themeluese e aplikuesit
- Biografi të shkurtëra të personave që përbëjnë ekipin e projektit të angazhuar në projekt (më së shumti për 5 persona).



**Afati i aplikimit deri më:
8.8.2022, deri në orën 14.00**

**<https://fitr.mk/startapuvaj4/>
startapuvaj4@fitr.mk**